



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut**  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik

01Nr. 60/01-16807/22  
Kaçanik, 21.06.2022

### PROCESVERBAL

Nga mbledhja **VI (gjashtë)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 21 Qershor 2022( e martë). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e komiteteve të Kuvendit, me fillim pune në ora 10:30.

Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Lejla Muhaxheri-Çaka-PDK, Arta Avdiu-LVV, Ekrem Livoreka-AAK. Ndërsa Betim Shala-LDK dhe Arben Thaqi- OJQ kanë munguar në mbledhje.

Nga Ekzekutivi i komunës në takim mori pjesë Hafize Sallahi –drejtoresh e Drejtorisë së Kulturës ,Rinisë dhe Sportit.

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka.  
Procesmbajtëse Arbnora Kuka, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

**z.Ekrem Livoreka**, Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e VI-të (gjashtë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2022, data 21 qershor, me këtë :

#### REND PUNE

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete;
2. Ndarja e granteve dhe subvencioneve për OJQ; dhe
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Komitetit për Komunitete

#### APROVOJ

**Redin e punës, në përbërje prej 3 pikave**

1.Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

**Kryesues i Komitetit, Ekrem Livoreka**, A keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo atëherë, a jeni për miratimin e këtij procesverbali ?  
Procesverbali i mbledhjes se V-të (pestë) të Komitetit për Komunitete i vitit 2022, u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se Komitetit për Komunitete e,

**Aprovoj**

**Procesverbalin e mbledhjes se V-të (pestë) të Komitetit për Komunitete të vitit 2022,  
të datës 24.05.2022 / Lënda : 01Nr.60/01-13732/22.**

## 2. Ndarja e granteve dhe subvencioneve për OJQ

**Kryesues i Komitetit, Ekrem Livoreka,** Fillimisht ja japim fjalën drejtoreshës së DKRS-së, Hafize Sallahi.

**Znj.Hafize Sallahi,** Ju përshëndes të gjithëve. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka një planë vjetor për vitin 2022, ku janë të përfshira aktivitete.

Në muajin Janar kemi shënimin e datave të rënjes së dëshmorëve.

17 Shkurt- shënim i përvjetorit të Pavarësisë së Kosovës, kemi pasur aktivitete në Shtëpinë e kulturës”Xheladin Kurtaj”.

5,6 dhe 7 Marsi, kemi pasur aktivitete me rastin e epopes së UÇK-së.

9 Prill ka qenë e paraparë të mbahet turneu memorial “Reshat Shehu”, por nuk është mbajtur sepse klub i shahut nuk është funksional, besoj se do të mbahet brenda vitit.

6 prilli – dita e sportit, është mbajtur defile e klubeve sportive të komunës së Kaçanikut.

22 Prill- dita e Tokës, është mbajtur nën patronatin e Kryetarit të komunës dhe DKRS-së dhe organizimi është bërë nga Organizatat KVRL dhe BONEVET, të cilat kanë qenë përfitues të subvencionit .Kanë pasur aktivitet edhe mbjelljen e fidaneve dhe luleve.

23 Prill- dita e Librit, është mbajtur aktivitet në Shtëpinë e Kulturës”Xheladin Kurti” nën menagjim të KVRL-së, si përfituese e subvencionit.

31 Maj- Nuk është mbajtur dita kundër duhanit, e cila ka qenë e paraparë të organizohet nga federata e futbollit.

Në maj ka qenë i paraparë festivali i fëmijëve, por për arsy që ishin në fund të vitit akademik,nuk është mbajtur, sepse ky festival mbahet me nxënës të shkollave filllore dhe të mesme dhe për këtë arsy është shtyrë për muajin shtator.

1 Qershori- dita ndërkombëtare e fëmijëve, është mbajtur aktivitet në Shtëpinë e Kulturës”Xheladin Kurti”.

Dita ndërkombëtare e sportit ka qenë me 5 qershor por ne e kemi mbajtur me 11 qershor, ku kanë defiluar 315 sportist, kanë mbjellur pemë te parku i qytetit dhe janë zhvilluar ndeshje në Palestrën Sportive.

Me datë 10 dhe 11 Qershor është mbajtur festivali ’Kaçaniku këndon”, i cili është organizuar nga një ansambël i cili ka qenë përfitues i subvencionit.

Këto janë datat të cilat kanë qenë të planifikuara deri tani.

Sa i përket subvencioneve , Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport për këtë vit ka ndarë 43500€. Në sport kanë përfituar:

Klubi futbollit ”Lepenci” shumën prej 16,400.00€;

Klubi basketbollit ”Kaçaniku” ,shumën prej 3,200.00€;

Klubi i handbollit ”Lepenci” , shumën prej 3,200.00€;

Klubi i volejbollit ,meshkujt, shumën prej 2,000.00€;

Klubi i volejbollit, femrat, shumën prej 2,400.00€;

Klubi i futbollit, femrat ”Bazeli”, shumën prej 2,800.00€;

Këto shuma ndahen në bazë të aktiviteteve dhe anëtarëve të cilët i ka klubit. Është formuar komisioni në përbërje prej 5 anëtarëve, 3 anëtarë kanë qenë nga DKRS dhe 2 anëtarë të jashtëm. Kemi edhe komision të monitorimit.

**Znj.Arta Avdiu,** Këto shuma që janë ndarë, a janë për 1(një) vit?

**Znj.Hafize Sallahu,** Po për 1(një )vit janë.Pedagogët e kulturës fizike, bëhet fjalë për shkollat e futbollit.Një ndër to e ka edhe Arbeni, por këto shuma prej 1,400.00€ i marrin pedagogët të cilët merren me sportistët e rinjë.

Klubi Taekwondo”Kaçaniku” ka përfituar shumën prej 1,500.00€;  
Alpinistët “Kaçaniku2015”, shumën prej 1,200.00€;  
KVRL e cila aplikon për aktivitete të cilat janë në kuadër të drejtorisë sonë, ka përfituar shumën prej 1,500.00€;  
Motorcross”Kaçaniku”, shumën 1,200.00€  
Klubi i mundjes “Kaçaniku”, i është ndarë shuma prej 2,200.00€, është grup i vajzave të cilat kanë korr shumë suksese, kanë sjellur shumë medalje. Këtij klubi i kam ndarë një sallë në palestrën sportive për të bërë ushtrimet.  
‘Trofta e Lepencit’ është një grup peshkatarësh , ka përfituar një shumë prej 1,200.00€  
Fondacioni “Bonevet”, ka përfituar një shumë prej 2,500.00€;  
Klubi i shahut”Lepenci” ka përfituar shumën prej 800.00€.  
Në fushën e kulturës janë ndarë 18500€, ku kanë përfituar 3 shoqëri kulturore artistike.  
SHKA”Tingujt e Vendlindjes” kanë përfituar shumën prej 4,500.00€. 2000€ për organizimin e aktiviteteve për javën e mërgimtarëve, i cili do të mbahet me datë 28 korrik. Ndërsa shumën prej 2500€, për aktivitete të tjera.  
SHKA”Gryka e Kaçanikut” ka përfituar shumën prej 5000€. Për organizimin e festivalit për fëmijë edicioni i 7 “Kaçaniku këndon” dy ditor.Aplikimi ka qenë në muajin shkurt për këtë festival dhe ka qenë i paraparë për tri ditë. Mirëpo tash me ndryshimin e çmimeve, 4000€ nuk mjaftojnë për tri ditë , dhe do të mbahet për dy ditë dhe shtyhet në muajin shtator. Shuma 1000€ për udhëtim në Tropojë.  
Qendra Kulturore”Kaçaniku” ka përfituar shumën prej 9000€, prej të cilave 6000€ për organizimin e festivalit tradicional dy ditor me datë 10 dhe 11 Qershor, në të cilin kanë marrë pjesë 8 ansamble nga Kosova,Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut. Ndërsa 3000€ për udhëtim 5 ditor në turqi.

**Znj.Arta Avdiu**, Falenderojmë drejtoreshën për sqarimet e nevojshme.

**Kryesues i Komitetit, Ekrem Livoreka**, Sa janë të kënaqura me këtë ndarje?

**Znj.Hafize Sallahu**, Ka pasur ankesë nga SHKA”Tingujt e vendlindjes”, pse i është ndarë festivali tradicional, Qendrës Kulturore dhe një ankesë nga grupi i alpinistëve. Asnjëherë nuk janë të kënaqur me çmime. Këto duhet të gjejnë donator, por fatkeqësisht kemi pak biznese që mund të ndihmojnë. Kam paraparë blerjen e një minibusi për transport dhe mund ta shfrytëzojnë të gjitha klubet dhe OJQ-të.

**Kryesues i Komitetit, Ekrem Livoreka**, Falenderojmë drejtoreshën e DKRS-së për sqarimet e nevojshme.

3.Të ndryshme

**Kryesues i Komitetit, Ekrem Livoreka**, Sipas planit të Komitetit për Komunitete, kemi 10 mbledhje për këtë vit, kam menduar që muajt korrik-gusht të kemi pushim. Secili mund të jepni mendimin tuaj. A keni diçka për të diskutuar? Nëse jo atëherë e shpalli mbledhjen të përfunduar, në ora 11:04.

Procesmbajtës  
Arbnora Kuka

